



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:239722  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05477644

C.nr.2023:239723

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Vjosa Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. M. nga fshati ...Komuna Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson av.Samir Rekaj nga Ferizaj, kundër të paditurës K.S.”S.” me seli në Prishtinë, për çështjen objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance me datën 18 mars 2024, morri këtë;

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.2023:239723, e paditëses A. M. nga fshati .... Komuna Ferizaj, kundër të paditurës KS”S.” me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike kompensim dëmi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit të tij, ka ushtruar padi më datë 07.11.2023, kundër të paditurës lidhur me çështjen juridike kompensim i dëmit.

Me datën 14.03.2024 në gjykatë nga i autorizuari i paditëses, është dorëzuar parashtrësja me anë të së cilës, paditësja ka bërë tërheqjen e padisë pasi që me palën e paditur ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore si dhe nuk ka më interes juridik në këtë çështje civile.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet ka vendosur konform nenit 456 par.1 lidhur me 450 të LPK-së, pasi që asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
C.nr. 2023:239723, me datën 18 mars 2024

Gjyqtarja  
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.